

URDHËR
Nr. 507, datë 26.9.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të shkronjës “r”, të nenit 10, të vendimit nr. 124, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të kapitullit 3.2, shkronja “A”, pikat 3 dhe 4, të rregullores së përgjithshme, “Për funksionimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e firmës së titullarit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, znj. Anila Minxhozi, me detyrë zëvendësudrejtor i përgjithshëm, të nënshkruajë çdo shkresë që del nga institucioni, në mungesë dhe me porosi të drejtorit të përgjithshëm të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni, për periudhën nga data 27.9.2018 deri në datën 5.10.2018.

2. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri zëvendësudrejtori i përgjithshëm do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjen e çështjeve dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

3. Nuk delegohen kompetencat e titullarit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Anila Minxhozi, zëvendësudrejtor i përgjithshëm.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Anila Denaj